



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.Nr.15/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Ekrem Salihu- Referues, z. Tefik Sylejmani – Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 39 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 02/2015, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues - /Policia e Kosovës/, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 të LPP-së, përkitazi me OE “Ajani&Ademi” -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rroba Civile për femra”, me nr.prok.214/16/129/111, më 27 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar, kërkesa e Autoriteti Kontraktues (AK) – /Policia e Kosovës/ e dt: 11.01.2017, për shkëputje të kontratës “Furnizim me rroba Civile për femra”, me nr.prok.214/16/129/111 dhe për diskualifikim të operatorit ekonomik “Ajani & Ademi”- Prishtinë, nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurim publik.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues /Policia e Kosovës/, me dt:11.01.2017 ka parashtruar kërkesë, në OSHP, që të shqyrtohet mundësia e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për diskualifikim të OE “Ajani & Ademi”-Prishtinë.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur, OSHP-ja ka caktuar seancë dëgjimore me dt:27.02.2016, e cila është mbajtur konform nenit 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, pa praninë e palëve të përfshira në Procedurë.

Gjatë prezantimit në seancën dëgjimore, ekspertja shqyrtuese e OSHP-së deklaroj 'AK-Policia e Kosovës ka parashtruar kërkesë në OSHP që të shkëputet kontrata lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me rroba Civile për femra", me nr.prok.214/16/129/111, si dhe të futet në listë të zezë OE konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, me arsyetim se OE i rekomanduar për kontratë – nënshkruesi i kontratës ka zvogëluar sasinë indikative të kontratës për 50%, me të cilën e ka dëmtuar buxhetin e AK-së në çmim për njësi në krahasim me OE-të tjerë.

OE është njoftuar me datë 24.11.2016 për shkëputje të kontratës në mënyrë miqësore konform nenit 29 paragrafi 2 të kushteve të veçanta të kontratës, mirëpo me këtë propozim nuk është pajtuar kontraktuesi, duke kërkuar se me çfarë baze juridike priset kjo kontratë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës vjen në përfundim se kërkesa e autoritetit kontraktues nuk përmbush kushtet e nenit 99 paragrafit 2 të LPP-së, që i njëjti OE të diskualifikohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik kur dihet qartë se në çfarë kushte mund të vendoset një OE në listë të zezë.

Po ashtu paneli shqyrtues konstaton se referimi i AK-së në nenin 132 të LPP, për shkëputje të kontratës nuk i përmbushë kushtet që kontrata në fjalë të shkëputet nga ana e OSHP-së, për faktin se në nenin 132 shkruan qartë se në cilat raste OSHP ose gjykata mund të shkëput një kontratë publike, ku në paragrafin 1.1 të këtij neni shkruan "*është dhënë pa publikimin e mëhershëm të njoftimit kur ishte kërkuar nga ky ligj*", që nënkupton që AK-ja ka respektuar procedurat prej njoftimit për kontratë e deri të procesi i nënshkrimit të kontratës, ndërsa në paragrafin 1.2 të nenit të lartpërmendur shkruan "*ishte përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontratës*". Duke pasur për bazë këtë paragraf dhe faktin se nuk ka pas ankesë në OSHP dhe nuk ka pas ndonjë urdhëresë nga OSHP-ja, për mbylljen e kontratës atëherë rezulton se është respektuar periudha e pritjes sipas neni 26 të këtij ligji.

Paneli shqyrtues konstaton se palët në procedurë kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale dhe kjo çështje më shumë i takon çështjeve gjyqësore, pasi që në kontratat ndërmjet palëve ceken edhe arsyet dhe mundësitë e shkëputjes së kontratave, mosmarrëveshjet eventuale apo nëse nuk funksionojnë këto metoda atëherë parashihen edhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore apo gjyqësore.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e prezantuar nga palët në procedurë, prezantimeve në seancën dëgjimore, pas shoshitjes së të gjitha provave konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktues për diskualifikim të operatorit ekonomik "Ajani & Ademi"- Prishtinë është e pabazuar.

Paneli shqyrtues, nga të cekurat më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, me kërkesë-padi mund ti drejtohet. Departamentit për çështje Administrative, në Gjykatën themelore në Prishtinë.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – "Policia e Kosovës"
- 1x1 OE - "Ajani & Ademi" -Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.